



"ANGERBA" sh.p.k.

ÇESME PUBLIKE RRESHEN + LINJA NGA BURIMI KULME RRESHEN

BASHKIA MIRDITE

PROJEKT ZBATIMI

RAPORT TEKNIK

QERSHOR 2024



ANGERBA shpk

RELACION TEKNIK
MBI PROJEKT ZBATIMIN PER OBJEKTIN
ÇEZME PUBLIKE RRESHEN + LINJA NGA BURIMI KULME -RRESHEN
BASHKIA MIRDITE

Ky Projekt Zbatimi eshte hartuar mbeshtetur ne detyren e projektimit dhene nga ana e Bashkise Mirdite.

I.- HYRJA

Vendndodhja: **Bashkia Mirdite**

- Aktualisht qyteti Rreshen ne territorin e tij ka rreth 5 900 banore.

Perpara viteve 1990 Qyteti Rreshen furnizohej me uje nga Stacioni i Pompimit i ndertuar ne anen e majte te rrjedhes se lumit Fan.Ky stacion i ndertuar rreth viteve 1960 merr uje ne dy puse shpimi dhe me ane te tubit te dergimit dergon uje ne depon me volum 800 m^3 te ndertuar ne kodren ne anen perendimore te qytetit ne Kolsh.

Pas viteve 1990 Per Ujesjellesin e qytetit Rreshen eshte investuar prej vitesh me ndertimin e linjes se furnizimit te ujit nga Burimi i Bargjanes me prurje rreth 30 deri 45 litra/sek.Si faze e pare rreth viteve 2000 per kete ujesjelles eshte ndertuar Vepra e Marrjes ne Bargjane me dy kaptazhe.Po ashtu u ndertua dhe linja e dergimit per ne qytetin e Rreshenit me gjatesi rreth 38 km.Ky ujesjelles furnizon qytetin Rreshen dhe fshatrat e Bashkise Mirdite.

Ne fazen e dyte te zbatimit rreth viteve 2014 deri 2015 u be plotesimi me ndertimin e rreth 20 depove me volum 25 m^3 deri 150 m^3 per furnizimin me uje te fshatrave dhe 2 depo me volum 500 m^3 sejcila nje ne Pergegaj dhe nje ne Kolsh per qytetin Rreshen.

Se fundemi gjate viteve 2018 -2019 u nderhy duke e plotesuar kete ujesjelles me keto nenobjekte :

1-Rrjeti Shperndares Primar

2-Rrjeti Sperndares Sekondar

3-Ndertim Depo e re 1000 m^3 se bashku me Dhomen e Sherbimit ne Kolsh

4-Linja e Tubacionit te Dergimit Stacion Pompimi deri ne Depon $2 \times 400\text{ m}^3$

5-Furnizimi me uje i Depos Egzistuese 500 m^3 ne Pergegaj se bashku me Kabinen Ajrore.

6-Punime ne Stacionin e Pompave Egzistues,Punime ndertimore,Elektromekanike dhe Mbrojtje nga Lumi Fan i Vogel.

Per nje funksionim dhe furnizim normal me uje te qytetit kerkohet qe te investohet per ndertimin e rrjetit te ri shperndares sekondar per shperndarjen e ujit nga linjat e reja kryesore deri te konsumatori.Ky investim do te mundesonte nxjerrjen nga funksionimi te rrjetit te vjeter,i cili eshte shume i amortizuar dhe do te eliminonte humbjet ne rrjet.

II.- TE DHENA TE DETYRES SE PROJEKTIMI

Detyra e Projektimit kerkon te hartohet projekti i zbatimit per ndertimin e kater cesmave publike per qytetin e Rreshenit dhe linjes se dergimit nga burimi i Kulmes me fondin e percaktuar prej **3 000 000** leke me tvsh.



ANGERBA shpk

KERKESAT QE DUHET TE ZGJIDHE PROJEKTI:

Projekti i hartuar duhet te permbaje:

1. Koorografine ne shkalle 1:25 000. (1:10 000).
2. Planimetrine e linjes se dergimit dhe te çesmave qe do te ndertohen
3. Detaje te ndryshme
4. Projekti i Çesmes.
5. Relacionin teknik per zgjidhjen e dhene sipas detyres se projektimit.
6. Preventivi i kryerjes se punimeve, duke u mbeshtetur ne çmimet e sistemit te integruar per informatizimin e Manualit te Çmimeve ,V.K.M. Nr. 216 ,date 13.04.2023 te shoqeruar me analizat perkatese.
7. Specifikimet teknike te zbatimit te projektit.

III.- RAPORTI TOPOGRAFIK

"ANGERBA" shpk, ka kryer matjet topografike per kete nenobjekt si me poshte :

Pikat dhe koordinatat konkrete ku ne kemi vendosur bazën e GPS-it tonë janë te dhena ne planimetrite perkatese.

Saktësia e realizuar në matje me GPS-in tonë është +- 1 cm në plan dhe +- 1.5 cm në kuotat për një rreth me rreze 5 000 metra (ose diametër 10 000 metra). Kjo saktësi është maksimalisht e mjaftueshme për kërkesat teknike të projektit.

Në të gjithë zonen e rilevuar ne kemi vendosur disa pika të forta me gozhde betoni dhe kunjja hekuri të cilat do të shërbejnë gjatë zbatimit të projektit (pikat poligonale).

Këto pika poligonale u shfrytëzuan njëkohësisht për gjithë rlevimin e zones.

Koordinatat planimetrike dhe altimetrike të këtyre pikave janë të paraqitura në fletet përkatëse, si dhe ne nje table te permbledhur.

Vendi ku do te ndertohet objekti eshte ne pronesi te **Bashkise Mirdite**.

Rilevimi eshte realizuar ne kete menyre:

Si fillim qe ne momentin e pare eshte bere rikonjicioni i zones dhe eshte vendosur per menyren e kryerjes se ketij procesi. Duke menduar qe te dhenat topografike do te jene sipas rrjetit koordinativ shteteror eshte filluar me grumbullimin e materialeve te nevojshme per transformimin e te dhenave tona ne kete rrjet. Keshtu nga hartat 1:25 000 te zones jane identifikuar pikat e triangolacionit Shqiptar dhe jane marre te dhenat nga Instituti Topografik Ushtarak per keto pika si dhe listen e reperave dhe te markave ne kete zone. Me pas eshte zhvilluar nje rrjet poligonal i mbeshtetur ne keto pika dhe duke perdorur teknologjine GPS. Me nje GPS baze dhe tre recivitor GPS eshte ndertuar nje rrjet trekendeshash per te llogaritur koordinatat e pikave te poligonit ne menyren me te sakte te mundur. Llogaritja e pikave poligonale te matura me GPS per çdo pike eshte skicuar nje vizatim per te treguar vendndodhjen e pikes ne lidhje me objekte fikse dhe e shoqeruar me fotografi dixhitale, kjo do te perbej monografine e pikave poligonale.

Gjithashtu jane fiksuar ne terren pikat fikse te fillimit dhe te mbarimit te rrugeve si dhe pika te tjera te rendesishme qe jane gjykuar te domosdoshme.



ANGERBA shpk

Te gjitha pikat e rilevuara ne terren jane te regjistruara me kode speciale ne memoriet e brendshme te instrumentave te perdorura nga ana jone. Pikat e regjistruara ne terren jane transferuar ne kompjuter me programet e realizuara perkatesisht per kete proces. Me vone te gjitha pikat jane perpunuar dhe u be krijimi i hartes dixhitale ne shkalle reale ne kompjuter. Ne terren jane rilevuar te gjitha pikat karakteristike per te pozicionuar te gjitha detajet. Rendesi te veçante i eshte kushtuar pozicionimit te detajeve si: ndertimet e ndryshme civile, elementet e infrastruktures, (rrjeti elektrik, telefoni, ujesjelles) etj. Programi qe eshte perdorur ka te vizatuar te gjithë elementet planimetrik. Te dhenat finale jane “file” dwg si dhe nje Model i Terrenit ne forme dixhitale ne formatin DXF per projektimin e rrugeve me programet perkatese. Te dhenat dixhitale permbajne te gjitha linjat e nderprerjes se terrenit per nje ndertim shume te mire te modelit tridimensional. Te gjitha detajet topografike jane te pranishem. Ndermjet te tjerave jane: rruge te asfaltuara dhe te pa asfaltuara, trotuare dhe kuneta, shtepi dhe mure mbajtes, peme, puseta egzistuese dhe te gjitha sherbimet e ndryshme urbane, kanale dhe rrethime siperfaqesh etj. Te gjitha pikat e matura jane te pranishme ne harten e krijuar. Izoipset jane krijuar nepermjet programit perkates.

IV.- BURIMI I FURNIZIMIT ME UJE

Burimi i furnizimit me uje eshte Gurra e Molles ne Kulme. Ky burim eshte i mire kaptazhuar prej shume vitesh qe kur eshte ndertuar ky ujesjelles per te furnizuar me uje Depon e ujr prane shtepise se Pjeter Haçit ne Qytetin e Rreshenit, me ane te tubacionit prej çelikume diameter $\varnothing 70/10$ mm. Ky tubacion ne segmentin e pare me gjatesi rreth 1 800 m eshte ne gjendje te mire. Ndersa segmenti prej aty dhe deri ne Rreshen eshte plotesisht i demtuar. Ne kete pike uji merret nga konsumatorët private me ane te tubave te vendosur nga vete ata. Me date 03.06.2024 nga ana jone u mor mostra e ujit dhe u dergua per analize ne Laboratorit te Sherbimit Gjeologjik Shqiptar.

Po ashtu eshte hartuar dhe Studimi Hidrogeologjik i ujit per kete burim. Ne kete studim thuhet se nga matjet e vitit 1975 ne kohen me prurje minimale nekemi nje prurje te burimit prej 0.9 litra/sek.

Projekti merr ne konsiderate burimin qe nga Studimi Hidrogeologjik e perballon nevojen per uje sot dhe ne perspektive per ndertimin e kater çesmave ne qytetin e Rreshenit per prurje te llogaritur 0.6 litra/sek.

V.- ZGJIDHJA TEKNIKE E PROJEKTIT

Grupi i projektimit me marrjen e detyres se projektimit beri rikonicionin ne vend me perfaqesues te Bashkise Mirdite .U bene matjet topografike te nevojshme, te vendit ku eshte i ndertuar kaptazhi te burimi i ujit te Gurra e Molles ne Kulme. Po ashtu u be matja topografike e aksit te linjes se re qe do te ndertohet.

Projekti ka parashikuar ndertimin e nje pusete te shuarjes se presionit ne piken ku do te merret uji nga tubacioni egzistues qe sipas detyres se projektimit per kete faze te zbatimit te projektit do te merret i mireqene. Te kjo pusete eshte parashikuar qe ujr qe vijne nga burimi mbi nevojen tone nepermjet teperplotesit te shfrytezohen perseri nga komuniteti i zones.



ANGERBA shpk

Ne nje kohe te dyte do te jete e nevojshme te nderhyhet ne kaptazhin egzistues dhe ne linjen e dergimit nga kaptazhi per te kjo pusete e shuarjes se presionit qe do te ndertohet.

Po ashtu eshte parashikuar ndertimi i nje linje dergimi me tub HDPE 100 DN 40 - 25 per ne qytetin e Rreshenit ku do te ndertohen çesma publike ne tre vende te percaktuara nga Bashkia.

Linja e dergimit ka nje gjatesi prej 2 631 ml dhe presion statik prej afro 9.2 atm

LLOGARITJA E TUBACIONEVE

Nr. Rendor	Emertimi i linjes	Gjatesia e linjes tub.	Numri i banoreve		Prurja "Q"			Diametri i tubit PE		PN atm	Shpejtesia V m/s	Humbjet l m/km	Humbje gjatesore m
			Sot	Persp.	Q llog	Q trans.	Q tot	DNj	DNb				
					l/s	l/s	l/s						
1	243-234	113			0.300		0.300	25	21.4	10	0.834	0.040292	4.553
2	234-219	168			0.450		0.450	25	21.4	10	1.251	0.085375	14.343
3	219-1	2 350			0.600		0.600	40	35.2	10	0.616	0.012885	30.280
	Shuma	2 631											49.1760

Projekti ka parashikuar qe ne segmentin e pare te linjes nga Pk.1 deri Pk.173 me gjatesi 1 757 ml kanali do te hapet me makineri.Ndersa prej aty deri deri ne perfundim te linjes te gjitha germimet do te kryhen me krah per shkak te kalimit te aksit te linjes ne rruge te shtruara me beton ,me asfalt ose ne trotuare.Kalimi i perroit te Kulmes do te behet te ura duke e futur tubin HDPE brenda tubit te çelikut Ø 51/5 mm.Po ashtu dhe kalimi i rruges se asfaltit do te behet ne te njejten menyre duke shfrytezuar tombinon egzistuese.

Projekti ka parashikuar ndertimin e tre pusetave te ajrimit me permasa 1x1x1 m ne Pk.40;120 dhe156.

Bashkelidhur ketij Relacioni eshte dhe Studimi Hidrogeologjik i burimit te ujit dhe Raporti i Testimit te ujit per Analizat fiziko-kimike.

VI.- KERKESAT E SIGURIMIT TEKNIK GJATE ZBATIMIT TE PROJEKTIT

Gjate zhvillimit te punimeve ne objekt **duhet te zbatohet rregullorja e teknikes se sigurimit ne ndertim** si me poshte:

Te plotesohen kerkesat higjieno sanitare per punetoret dhe mjetet ne objekt.

Nga kontraktori duhet te sigurohen mjetet mbrojtese kolektive dhe individuale si veshmbathje, mjete mbrojtje, etj.

Te behet instruksioni teknik i sigurimit te punonjesve sipas proceseve te punes qe kryhen ne objekt.

Ne objekt duhet te mbahet rregullorja e sigurimit teknik dhe protokollet per instruksionet e dhena nga personeli inxhinjero teknik.

Te punohet sipas plan organizimit te punimeve per cdo nenobjekt sipas grafikut te percaktuar ne kontrate.



ANGERBA shpk

Te instruktohen drejtuesit e makinerive meqenese punohet ne zona te banuara, paraprakisht te bejne kontrollin e terrenit ku kalojne linjat me qellim qe te mbrohen nga renia ne tension ose demtimi i punimeve te maskuara te infrastruktures ekzistuese.

Per me hollesisht kontraktori duhet te zbatoje Rregulloren e Sigurimit Teknik per punen ne ndertim, dhe nga ISTN-ja ne shtator 2000.

VII.- AFATI I KRYERJES SE PUNIMEVE

Projekti parashikon qe per kryerjen e punimeve per objektin **“Çezme publike Rreshen + Linja e dregimit burimi Kulme - Rreshen”**, nevojitet nje afat prej 60 ditesh. Menyra e kryerjes se punimeve jepet ne grafikun bashkelidhur raportit teknik.

VI.- ORGANIZIMI I PUNIMEVE

Për ndërtimin e objektit **“Çezme publike Rreshen + Linja e dregimit burimi Kulme - Rreshen”**, Bashkia Mirdite projekti parashikon të përdoren materiale të cilësisë së lartë sipas standarteve të vendit dhe ndërkombëtare dhe të zbatohen me rigorozitet Kushtet Teknike të Zbatimit të punimeve.

Betonet jane parashikuar te prodhohen me betoniere ne vend por edhe mund te merren tek fabrikat e betonit si beton me i garantuar.

Gjate ndertimit të këtij objekti të kihet parasysh gjithashtu:

- 1.- Betonet janë parashikuar të jenë të markës C 16/20
- 2.- Të gjitha betonet janë parashikuar të formohen me betonforma .
- 3.- Nuk do të hidhet beton pa përdorur vibratorin

Të kihen parasysh Kushtet Teknike të Zbatimit të punimeve për punimet me tubacione çeliku si dhe Kushtet Teknike për provat me ngarkesë të tubacioneve dhe depove.

Materialet ndertimore do te merren ne piken me te afert te furnizimit duke patur parasysh kerkesat e specifikimeve teknike.

Vlera e punimeve te objektit **“Çezme publike Rreshen + Linja e dregimit burimi Kulme - Rreshen”** duke u mbeshtetur ne çmimet e marra nga Sistemi i Integruar për Informatizimin e Manualit të Çmimeve për Zërat e Punimeve në Ndërtim, VKM Nr.216, date 13.04.2023 dhe hartimi i analizave per zerat qe nuk jane ne kete manual eshte **3 682 667 lek me tvsh.**

“ANGERBA”shpk
Ing.Burhan HAFIZI

